



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

VËRTETIM I NJËSISË ME ORIGINALIN

Nr. repertori: 3536

Tirane më 21/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021053950247673559

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



**DATE 21/04/2021
NR REP 3536**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGJINALIN

Sot, më datë 21/04/2021, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit personalisht:

KËRKUES/IT:

Zhaneta Bedaj, atësia Abas, amësia Xhevrije, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë Nikolla Jorga; Nd. 9; H. 4; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 01/05/1977, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033866449 dhe nr. personal H75501236Q, .

E cila me kerkoi te vertetoj: KONTRATE PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE i dates 16.03.2021 midis Z.Renis Tershana dhe Z.SHpetim Emiri.

Unë Noteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja “i”, nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU





KONTRATE PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE

Sot, në datën 16.03.2021, palët e mëposhtme nënshkruan këtë Kontrate Transferimi Aksionesh me kushtet dhe afatet e parashikuara më poshtë:

1. **Z. Renis TERSHANA**, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë më 23.09.1971, banues në Tiranë, në adresën Rruga Elbasanit Nr.17, mbajtes i pasaportes me Nr. SJ0883912, madhor me aftësi të plotë ligjor për të vepruar,
(Këtu e më poshtë referuar si “**Shitësi**”)

Dhe

2. **Shpetim Emiri**, shtetas shqiptar, i lindur në Gjirokaster më 24.01.1948, mbajtes i ID leter njoftim Nr.034803488 dhe numer personal E80124069T, madhor me aftësi të plotë ligjor për të vepruar.
(Këtu e më poshtë referuar si “**Blerësi**”);

Dispozita të Përgjithshme

- A) Shitësi i lartpërmendur është zotëruesi i aksioneve përkatëse me të drejtë vote (465,725 aksione ose 0.5% të total aksioneve) në shoqerine “**BANKA CREDINS**” sh.a. (këtu e më poshtë referuar si “**Shoqeria**”), një shoqeri aksionere e themeluar në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi, me seli në adresën – Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Vaso Pasha, Nr. 8, Tiranë, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NIPT K316088010 dhe te dhenat e kapitalit aksionar dhe te ndare në aksionet perkatese të publikuara në Regjistrin Tregtar prane Qenres Kombetare të Biznesit.
- B) Shitësi pranon të shesë duke i kaluar Blerësit titullin e pronësisë për 179,964 aksione (“**Aksione që do të transferohen**”) të zotëruara prej tij në kapitalin aksionar të shoqerise, në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate për shit/blerjen e aksioneve (“**Kontrate për Transferim Aksionesh**”) ose (**KTA**). Shitësi do t’i kalojë/transferoje Blerësit aksionet vijuese dhe pjeset korresponduese ne kapital të barabartë me 179,964 aksione (siç u përmend edhe më lart) 0.193% të totalit të aksioneve;
- C) Blerësi pranon të blejë nga Shitësi “**Aksionet që do të transferohen**”, si më sipër, në përputhje me kushtet dhe nenet e kësaj kontrate për transferimin e aksioneve.
- D) Pas blerjes së aksioneve të lartpërmendura në kapitalin e shoqërisë “**BANKA CREDINS**” sh.a. nga Shitësi, në përputhje me këtë KTA, legjislacionin në fuqi, miratimin eventual ne



perputhje me Statutin e Shoqërise “Banka Credins” sh.a. (aktet e mirebesimit dhe leter miratimet, sipas Statutit te Banka Credins) dhe permbajtjen e kesaj kontrate, Blerësi do të bëhet aksioner i shoqërise me të drejta të caktuara, të parashikuara në këtë KTA, aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi;

- E) Palët nënshkruajnë këtë Kontrate Transferimi Aksionesh, me qëllimin për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e Palëve lidhur me blerjen nga Blerësi të aksioneve që do të transferohen (*siç parashikohet këtu e më poshtë*) dhe për të përcaktuar çështje të tjera, që lidhen me këtë transaksion. Palët bien dakord se të gjitha çështjet e lartpërmendura do të interpretohen, do të trajtohen si dhe do të rregullohen vetëm në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë Kontrate.

Duke marrë parasysh sa më sipër dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime të përgjithshme

- 1.1 Të gjitha shtojcat dhe anekset janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Kontrate Transferimi Aksionesh.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

- 2.1 Duke pranuar kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Transferimi Aksionesh, Shitësi dëshiron të shesë kundrejt shlyerjes së çmimit të blerjes dhe Blerësi pranon të blejë **0.193%** të totalit të aksioneve të zotëruara nga Shitësi në Shoqërinë (Banka Credins), siç është përshkruar në dispozitat e përgjithshme, si dhe çdo të drejtë që lind nga dhe ka lidhje me këto aksione, për një shumë të barabartë me **179,964** të aksioneve me të drejtë vote.
- 2.2 Në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara në këtë Kontrate, Shitësi do t'i shesë, kalojë, transferojë, japë dhe dorëzojë Blerësit, si dhe Blerësi sipas kësaj Kontrate do të blejë, marrë dhe pranojë nga Shitësi, pa asnjë barrë, të drejtat, titullin dhe interesat e Shitësit, me kusht që Blerësi të ketë kryer pagesën e çmimit të blerjes së aksioneve që do të transferohen, si dhe të ketë marrë të gjitha miratimet e parashikuara nga aktet nënligjore të shoqërisë.
- 2.3 Aksionet objekt shitjeje i transferohen Blerësit me të gjitha të drejtat që shoqërojnë apo kanë lidhje me to.



Neni 3

Çmimi i blerjes. Kalimi i pronësisë

- 3.1 Për blerjen e Aksioneve që transferohen, Blerësi do t'i shlyejë Shitësit çmimin e blerjes në shumën prej **300,000€** (treqind mijë euro), sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje ("**Çmimi i Blerjes**").
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi do të paguajë në emër të z. Renis Tershana një shumë prej 100,000€ (njëqind mijë euro). Diferenca prej 200,000 euro (dyqind mijë euro) do të paguhet nga Blerësi brenda një afati jo më larg se sa 1 (një) vit nga nënshkrimi i kësaj kontrate.
- 3.3 Totali i lartpërmendur përbën çmimin e blerjes.
- 3.4 Blerësi do t'i kryejë Shitësit pagesën e Çmimit të Blerjes përmes llogarise bankare.
- 3.5 Kushtet kumulative për kalimin e pronësisë mbi aksionet e lartpërmendura, janë si më poshtë:
 - Jane siguruar miratimet nga të gjithë aksionerët e shoqërisë, që zotërojnë aksione të tipit "A", si dhe nga dy (2) anëtarë të Menaxhmentit;
 - Shitësi dhe shoqëria kanë vënë në dijeni BANKËN E SHQIPËRISË për këtë transferim aksionesh në përputhje me Ligjin;
- 3.6 Kjo Kontrate do sjelle efektet e saja ligjore në lidhje me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi të Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe kryerjen e pageses prej 100,000 euro, nderkohe që Blerësi mbetet debitor kundrejt Shitesit për pagesën e diferencës prej 200,000 euro brenda afatit prej 1 viti nga nënshkrimi i kësaj kontrate. Në rastet e tejkalimit të këtij afati do të ndiqet rruga e percaktuar në ligj dhe Statut për përmbushjen e kësaj pagese në favor të Shitesit. Kjo kontrate regjistrohet në Regjistrin e Aksioneve të shoqërisë, pasi të jenë dhënë të gjitha miratimet e nevojshme sipas Statutit të Shoqërisë "Banka Credins" sh.a..
- 3.7 Kjo Kontrate për Transferimin e Aksioneve do të regjistrohet në regjistrin e aksioneve dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

Deklaratat, Zotimet dhe garancitë

- 4.1 Palët deklarojnë dhe garantojnë si më poshtë:
 - (a) Shitësi deklaron se aksionet me të drejtë vote (objekt i kësaj kontrate) janë të lira nga çdo barrë siguroese, peng, hipotekë, garanci mbi interesat, kufizim, e drejtë e parablerjes, pretendim, detyrim vote, ose nga çdo marrëveshje tjetër lidhur me votat apo angazhimet e tjera të çdo lloji (secila e referuar këtu e më poshtë si "Barra");
 - (b) Aksionet me të drejtë vote, objekt i kësaj kontrate, do të kalohen nga Shitësi të Blerësi, dhe do të regjistrohen sipas rregullave me emrin dhe titullin e pronësisë së Blerësit në Regjistrin e Aksioneve të Aksionerëve menjëherë pasi Blerësi të kryejë

pagesën e çmimit të blerjes dhe pasi të merren rregullisht të gjitha miratimet e tjera, si më sipër.

- (c) Nënshkrimi dhe plotësimi i kushteve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga palët nuk bie në kundërshtim apo nuk cenon ndonjë nga kushtet apo dispozitat e: (i) statutit apo akteve të tjera nënligjore në fuqi të shoqërisë, (ii) çdo vendim, urdhër, vendim gjyqi, dekret apo vendim të çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, qoftë i huaj apo vendas, së cilit i përket Shitësi, Blerësi ose Shoqëria, (iii) çdo marrëveshje, licencë apo angazhim pjesë e së cilës është Shitësi, Blerësi ose shoqëria, mund dobësojë aftësinë e palëve për të nënshkruar apo për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje, ose (iv) legjislacionin në fuqi.
- (d) Në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi përfaqësojnë dhe garantojnë se cilat përfaqësime dhe garanci do të konsiderohen të përsëritura, të vërteta, të plota dhe të sakta në të gjitha aspektet, se:
- i) Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a. është organizuar dhe themeluar sipas rregullave, vepron në mënyrë të vlefshme dhe gëzon një pozitë të mirë sipas legjislacionit shqiptar;
 - ii) Blerësi gëzon të drejtën t'i zbatojë dhe përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, dhe të gjitha miratimet e korporatës, të aksionerëve dhe miratime të tjera (sipas rastit) të dhëna në mënyrë të vlefshme si autorizim për ekzekutimin, përmbushjen dhe realizimin e këtyre detyrimeve dhe kjo Kontrate përfaqëson një detyrim ligjor të vlefshëm dhe detyrues, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e parashikuara në të.
 - iii) Ekzekutimi, përmbushja dhe realizimi i detyrimeve të tyre në përputhje me këtë marrëveshje/kontrate nuk dhe nuk do të: a) shkelë asnjë ligj, nuk do të cenojë ose përbëjë një mosplotësim të detyrimeve në përputhje me këtë marrëveshje dhe ligjin në fuqi; b) rezultojë në shkeljen apo cenimin e, ose nuk do të përbëjë (me ose pa njoftim, përfundim të afatit, ose të dyja) një mosplotësim të detyrimeve (ose do të shoqërohet me të drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përshpejtimit të ndonjë detyrimi, ose humbjes së ndonjë përfitimi material) në përputhje me afatet, kushtet apo dispozitat e çdo njoftimi, kontrate, hipoteke, marrëveshjeje, kontrate qiraje, ujdje apo marrëveshjeje tjetër, instrument apo detyrim pjesë e së cilës ajo është ose përmes së cilës pronat apo asetet e saj mund të jenë të kufizuara;
 - iv) Të gjitha miratimet (siç është përmendur edhe në këtë KTA) do të jepen në përputhje me ligjin, me qëllim për të bërë të ligjshme kalimin e pronësisë, sipas parashikimeve të mësipërme.
- (e) Të gjitha informacionet e bazuara në fakte të siguruara prej tij apo në emër të tij për qëllime të kësaj Marrëveshje/Kontrate, janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha





aspektet materiale që nga data e vënies së tyre në dispozicion, ose që nga data (nëse ka) që këto informacione u deklaruan.

Neni 5

Zgjidhja e Kontrates dhe hyrja në fuqi

Kjo Kontrate mund të zgjidhet me pëlqimin e përbashkët të palëve. Kjo Kontrate do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga palët pjesëmarrëse.

Neni 6

Forca Madhore

- 6.1 Mospërbushja e detyrimeve të kësaj Marrëveshje/Kontrate nga palët nuk do të konsiderohet shkelje e kësaj Marrëveshjeje/Kontrate për aq kohë sa detyrimet nuk përmbushen për shkak të një fenomeni të konsideruar forcë madhore, në rastin kur provohet se pala e prekur nga ky fenomen (a) ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake për të përmbushur kushtet dhe afatet e kësaj marrëveshjeje dhe (b) ka njoftuar palën tjetër menjëherë pas ndodhjes së këtij fenomeni. Forcë madhore do të konsiderohen të gjitha urdhrat, rregulloret, direktivat e qeverisë së shpallura në formën e ligjit apo në një mënyrë tjetër, ose çdo lloj sanksioni me natyrë kombëtare apo ndërkombëtare, kryengritje, luftë (e deklaruar apo jo) për grupet terroriste, guerilase, apo individët, grevat, zjarret, tërmetet, ose çdo shkak tjetër, i cili nuk varet nga vullneti i palëve, ose nuk është pasojë e neglizhencës së palëve, të cilën ata nuk ishin në gjendje ta parashikonin.
- 6.2 Çdo periudhë kohe, gjatë së cilës një nga palët do të ndërmarrë veprime bazuar në këtë marrëveshje, do të zgjatet në përputhje me periudhën gjatë së cilës pala nuk kishte mundësi të zbatonte këtë marrëveshje për shkak të Forcës Madhore. Në rast se fenomenet e Forcës Madhore zgjasin më shumë se 3 muaj, palët do të jenë të lira ta zgjidhin në mënyrë të njëanshme këtë Marrëveshje/Kontrate pa asnjë lloj penaliteti.

Neni 7

Dispozita të Ndryshme

- 7.1 Kjo Kontrate mund të ndryshohet vetëm mbi bazën e një akti me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës Palë.
- 7.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi apo ekzekutimi i kësaj kontrate do të zgjidhen në mënyrë miqësore. Në të kundërt, gjykata kompetente për zgjidhjen e çdo çështjeje do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në rastin e një procesi gjyqësor, gjykata kompetente do të bazohet dhe do të zbatojë legjislacionin përkatës së Republikës së Shqipërisë.
- 7.3 Me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontrate, të gjitha drejtat dhe detyrimet e palëve do t'i transferohen dhe do të trashëgohen dhe në përputhje dispozitat e ligjit në fuqi, nga trashëgimtarët, personi zëvendësues i palëve, përfituesi i



palëve. Asnjë nga të drejtat, privilegjet dhe detyrimet e parashikuara sipas kësaj kontrate nuk mund të transferohen apo të kalohen pa marrë më parë miratimin me shkrim të të dyja palëve.

- 7.4 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara për t'u dhënë në përputhje me këtë kontrate, do të bëhen me shkrim dhe duhet të dërgohen me faks, postë rekomande në adresat që palët kanë lënë me shkrim për njëra-tjetrën.
- 7.5 Kjo kontrate është e hartuar në 4(katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

PALËT

SHITËSI

Renis TERSHANA

BLERËSI

Shpetim EMIRI